



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E PROKURIMIT

Nr 059/2021

Nr. Protokolli: 87/2021

Për:	CONSTRUMAX SH.P.K., Rr. Mentor Krasniqi p.n. Bukosh, 23000, Suharekë
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit
Lënda:	VENDIM
Datë:	11.06.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesave për Rishqyrtim të derguar në Platforme Elektronike të datës 07.06.2021, të parashtruar nga Operatorët Ekonomik: **CONSTRUMAX SH.P.K., Rr. Mentor Krasniqi p.n. Bukosh, 23000, Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Blerja e paisjeve dhe montimi i sistemit të menaxhimit të radhes si dhe shenjave sinjalizuese digjitale** me Nr. të Prokurimi: 624-21-1141-1-2-1& 624-021-060-121 -nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e datës **07.06.2021** të parashtruar nga Operatorët Ekonomik: **CONSTRUMAX SH.P.K., Rr. Mentor Krasniqi p.n. Bukosh, 23000, Suharekë** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Blerja e paisjeve dhe montimi i sistemit të menaxhimit të radhes si dhe shenjave sinjalizuese digjitale** kundër Njoftim për Vendimin e AK –së, të datës **03.06.2021** të publikuar në platformen elektronike.
2. **Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK** të publikuar me datë: **03.06.2021**.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë **25.05.2021**, ka pranuar kërkesa për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit **Blerja e paisjeve dhe montimi i sistemit të menaxhimit të radhes si dhe shenjave sinjalizuese digjitale** me Nr. të Prokurimi: **624-21-1141-1-2-1& 624-021-060-121** kundër Njoftim per Vendimin e AK –së, të dates, **03.06.2021** të publikuar në platformen elektronike.

Autoritetit Kontraktues pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesen tuaj, vlerëson se nuk ka bazë për shkelje të procedurave ligjore të prokurimit publik gjatë vlerësimit të tenderëve, dhe se komisioni për vlerësim dhe krahasim të tenderëve ka vlerësuar drejt, duke analizuar dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar dhe se pretendimet tuaja nuk qendrojnë, ngase ne oferten tuaj, , **te dokumentacioni i biznesit, çertifikata e biznesit ne informatat nuk ka shifer te veprimtaris ekonomike qe te ushtron kete aktivitet biznesor ku ne baze te ketij dokumenti dihet veprimataria e punes andaj ju posedoni tjera veprimtari dhe jo vepromtari e cila ka te beje me kete aktivitet. Andaj dhe si i till oferta juaj është refuzuar.**

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

